


	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorin Ekonomik: “Enex Trade” Sh.p.k. me adresë në Pejë Operatorin Ekonomik: “Mirusha Company” Sh.p.k. me adresë në Klinë Grup i Operatorëve Ekonomik: “SA-SALLAHU” Sh.p.k. & “GROMA HOLD” me adresë në Kaçanik Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, U.D. Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	07.10.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës:

04.10.2019, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik:

- Operatorin Ekonomik: “Enex Trade” Sh.p.k. me adresë në Pejë
- Operatorin Ekonomik: “Mirusha Company” Sh.p.k. me adresë në Klinë
- Grup i Operatorëve Ekonomik: “SA-SALLAHU” Sh.p.k. & “GROMA HOLD” me adresë në Kaçanik,

lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI DERI NË XËRXË**, me Numër të prokurimit: **623-19-6202-5-1-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-057-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa të parashtruar nga Operatorët Ekonomik:

- Operatorin Ekonomik: “Enex Trade” Sh.p.k. me adresë në Pejë
- Operatorin Ekonomik: “Mirusha Company” Sh.p.k. me adresë në Klinë
- Grup i Operatorëve Ekonomik: “SA-SALLAHU” Sh.p.k. & “GROMA HOLD” me adresë në Kaçanik,

lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI DERI NË XËRXË**, me Numër të prokurimit: **623-19-6202-5-1-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-057-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 30.09.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

- II. Autorteti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI DERI NË XËRXË**, me Numër të prokurimit: **623-19-6202-5-1-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-057-5-1-1**, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatorët Ekonomik:

- Operatorin Ekonomik: "Enex Trade" Sh.p.k. me adresë në Pejë
- Operatorin Ekonomik: "Mirusha Company" Sh.p.k. me adresë në Klinë
- Grup i Operatorëve Ekonomik: "SA-SALLAHU" Sh.p.k. & "GROMA HOLD" me adresë në Kaçanik,

lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI DERI NË XËRXË**, me Numër të prokurimit: **623-19-6202-5-1-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-057-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 30.09.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 04.10.2019, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari nenin 1 Qëllimi:

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla, të Ligjit për Prokurimin Publik të konsoliduar me Nr/ 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues hedh poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se AK Komuna e Rahovecit ka vlerësuar ofertat në përputhje me LPP-në.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
U.d. Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit